~~~
~~~

Ritual abstrakt

gjuha që lidh dy kohë fjalësh

sepse sytë e thonë më mirë

atë çka thuhet por harrohet

heshtja

ajsberg ndjenjash

flet me gjuhën e së tërës

2 Sërisht këtë natë

Të kisha premtuar e betuar…

për ty s'do kisha më mall,

por zemra nuk pyet për betime.

erdha pranë pa zhurmë e fjalë.

Askund s'të pashë,

qoftë dhe për një cast.

Me muzgun largohem,

duke tërhequr lotin e heshtur zvarrë.

E di…

me zemrën tënde je duke u grindur.

Eh, sikur t'a dije do të vije pranë.

Lotin të thanim vështrimit të zjarrtë,

jetën t'a fillonim sërisht këtë natë.

3 Kur qyteti fle

Vështrimi ndez errësirën,

e shndërron në flakë.

Freskia flladitëse zgjon jetën,

i jep dimension të ri.

Yjet kërkoj hapësirës.

Arrij t'i mbledh, t'i sjell në sy.

E përhumbur mes qetësisë,

agimin shpresëprurës pres qetë.

Hëna nëpër natë luan me një re…

unë, mes buzëqeshjes

puth qytetin tim kur fle!

4 Fëmijëria

Poemë e mbetur sirtarëve të harruar,

e brishtë, pa bujë e reklamë!

Kështu ngele ti, fëmijëria ime ëndrraplot .

Gdhendur në kohë pa fjalë!

Kujtimet varur, mbuluar nga e gjata pritje.

Këngë e pakënduar, poezi e ngecur në grykë.

Fëmijëria ime!

Buzëqeshje e ngrirë mbi vështrim pafajsie .

U rritëm shpejt.

Gjurmët e fëmijërisë na mbetën larg !

Rendëm të kapnim ëndrrat ,

siç gjurmonim dikur,

xixëllonjat mbrëmjeve në pranverë !

Me dhimbje në shpirt konstatova;

kohën që kish ngelur kacavjerrë mbi manaferrë

5 Ritmi i kohës

Kohë e trullosur

gënjeshtrave elegante.

Mbi durim të vrarë

trupin shtriq,

pikëpyetjet…

mbi sofër i ul këmbëkryq

Zëri i zhytur

pabesisë rituale,

përcjell heshtje tinzare.

Mbyllet sipar premtimesh!

Hapet sipar shpresëdrobitur

Një tjetër start zvarritjesh,

për njerëz me zemërtronditur

-A do të mundemi një ditë ne…

të rendim ritmit kohës?!

6 Nuk e di…

Shumë kohë nga jeta ime

dua të të dhuroj natyrë.

Frymën mbush mushkërive të tua.

Kur udhëtimin nis

drejt kraharorit tënd të gjërë,

në tërë qënien time derdh pranverë.

Rend pastaj fushave të blerta,

i gëzohem ledhatimit si fëmia,

kur bari luan me gjurmët e mia.

Sakaq lumturia …si ujë burimi,

vesh kristale vështrimit tim të ngazëllyer.

Nuk e di; a quhet kjo, një dashuri e këmbyer?

7 Dua të shkoj larg…

Veten kam humbur

nëpër labirinthet e kohës moderne,

që si një hije e çuditëshme,

zgjatet mbi rrudhat e mia t'i prekë.

Diku në një skutë të saj,

edhe ti vrapoje të gjeje strehë.

Sëbashku, lidhur kurorë

drejt së ardhmes vrapojmë,

por përsëri na mban të ndarë

kjo e pamëshirëshme kohë.

Ndërsa mbi supe mbajmë

kohën e pa kohë,

bota ecën mbrapsht

duke treguar gjiret shterpë të saj.

Kam humbur veten qorrsokakëve,

dua të shkoj larg…

Të ndodhem dua...

ku pihet ujë qetësisht,

jastëku qiellor

të më lexojë ëndrrat kaltërsisht.

Të arratisem …

të freskohem në ujrat e lumit 'Jordan',

ku loti bëhet vesë, puthja valë

e fryma me erën ngjan,

Pastaj… oh pastaj të kthehem

vetëm atëhere, kur bota të ecë mbarë.

Kam humbur veten fjalëkryqeve pa zgjidhje,

ndaj ... dua të shkoj larg.

8 Dashuri hyjnore

Dashuri ndryshe

që vjen me fuqi dinosauri

dhe drejt së ardhmes

zvarrit veladonin tënd të purpurt

ke lindur në vorbullën e pafajësisë

në terrin e mëngjër të meteorit, zbutesh

prej lotit të dhimbjes që s'rresht

fal tokë e qiell për një vështrim

shkëmben shpirtrat në udhën e syve

ku kapilarët e hollë

shtypur prej gishtrinjëve

ndezin tingujt e gjakut

deri ne vrazhdesi

puthja ndjek ritmin e zërave të heshtur

të dridhur

nga parajsa në ferr

Dashuri që lind e heshtur

dhe vdes zhurmshëm ndonjëherë

9 Kur dielli ngroh valën

Shkëputem nga zhurma,

të kuvendoj me valën,

në hapësirën e kaltër,

të gjërë, shoh sytë e tu,

në shpatet e kodrave

marr tëndin përqafim.

Nëse dielli i nxehtë,

më djeg pak shpinën…

shtëpia e shpirtit tim,

mbetet midis jetës vdekjes,

në këtë jubile të një ditë plot rreze,

ashtu si, sytë e tu plot gjallesë.

Ndaj, të lutem,

merre në këngën tënde, puthjen time,

vishja atij lisi të fortë,

ta mbajë gjithnjë ngrohtë,

në natyrën e qetë të jetëve tona,

zbukuruar në dekore puthje - përkëdhelje,

derisa të rrahin këto dy zemra të brishta,

por të forta,

si vetë trungu i tyre,

rrënjosur thellë viteve,

sepse dielli do të vazhdojë

të ngrohë valën, ende,

për shumë kohë…

10 A ka matje dashuria?!

Kam provuar disa herë

të mat dashurinë për Atë,

Mendimet

shpërhapen hapësirës,

midis qiellit e tokës,

Në çdo vend

shoh të më shfaqet,

ai trup

që lëviz

hijshëm nëpër lëndina;

Ndonjëherë mendjes sime

e fantazoj

ulur në një fron si mbret.

(E pyes veten: "Në fakt

çfarë ka mbreti?!)

Filloj arsyetimin:

Mbret është ai, pushtuesi

i një zemre,

di ta ushqejë e udhëheqë

ndjenjën e vet,

mes pasionit dhe përkujdesjes

së jashtëzakonshme …

Ndodh,

Zemra ime rebelohet,

Ai hesht,

merr dorën

e vendos në rrahje,

aty, gjithçka ngrin,

qetohet…

Heshtje!...

Shpirti më merr,

duke më shndërruar

në udhëtar shëtitës

në skajet më të largëta

të tokës,

Atje…,

Ku u fshehka

magjishëm dashuria!

E veçanta:

Vetëm ne të dy,

ndodh të pështërisin …

Cicërima zogjsh mbi flokë,

kur valët

përpijnë shpirtërat tanë

njëkohësisht,

ndodh

të pijmë

ndonjë gotë lotësh

në matje të dashurisë…

Treguesi arrin vonë…

***

1 Sa ftohtë këtë natë!

Era e ftohtë përplaset mbi shpinën time,
Gjethet jargavanësh varur kokën,
Pllakëzat poshtë këmbëve ngrirë,
Një rrënqethje trupi vesh zemrën acar,
Qielli pemëve u ka veshur mantel gri,
Buzëqeshjet e njerëzve venitur para diellit të munguar,
As zogjtë s'këndojnë këtë buzëmbrëmje,
Unë, bashkë me zogjtë,
paskam shumë ftohtë këtë natë...

2 Vrite dhimbjen...

Një pikë loti ra mbi bar,
dikush me këmbë e shkeli,
Toka e përpiu, e bëri baltë,
Askush nuk e pa...

Disa pemë pranë përjetonin
diellperëndim.
Sa lot janë kthyer në përbaltjje
mbi këtë tokë,
pa asnjë dëshmitar,
shpirtkëputur dhimbje, duke vrarë?!...

3 Me frymë petalesh…

Çudi…!
Kur rrufe të sjell ndër duar
grushthapur më dhuron
Flakë…
Ndodh
mërzitem nga retë,
Ti
qiellin hap,
dialog me diellin
duke përcjellur
Erën,
kur mbi flokë ta sjell,
Buzët gjallëron
me frymë petalesh…
Kur ndal shiun
mbi trupin tënd,
buzëve,
ua than etjen,
Diellin, kur ta sjell

zbut nxehtësinë e tij
nën hije pemësh.
Pranë ta sjell
Detin,
më sjell mbi supe
pulëbardhë perëndore.
Sa çudi me ty!

4 Rrugë meteori

Rrugë meteori
m'u bëre,
derisa
në oqean të thellë
u shua,
Hëna
lotonte
në heshtje,…
Zgjata
vështrimin,
pashë
fytyrën tënde
ne sytë e hënës,
Degë pemësh,
kryqëzuar
trishtueshëm,
varnin krahët
mbi muzg…

5 Shpirti rënkon

* * *

Shpirti rënkon
në heshtje…
Gjaku pulson
vrullshëm në deje…
Shpirti dhe gjaku
pse nuk bëjnë paqe
me ndjenjën ?!

* * *

Qiellit ia fshiva
lotët,
Retë ia mblodha
në grusht,
U çelën lulet
kaltërsisë,
Lumenjtë rendnin
çmendurisë…

* * *

Degëveshurat
me gjethe pranvere,
pikturoheshin
Mbi valet e lumit
të thellë,

Piktura
arratisej në qiell..

* * *

Bari kundërmonte
aromë vese mëngjesore,
Nga lotët kristalinë
pikuar,
varin kokën zymbylat
për të rikandiduar
në zgjedhjet e dyta…

* * *

Përroi humbi rrugën,
në rrënjët e lisit të moçëm…
Gjethet u shkëputën pemës,
ranë mbi lumë…
Jeta, mes lulesh,
më dehte aromës,
shpëtuam, së fundi,
nga pranvera e plumtë…

6 Aromë bari

Gjethekurorë
syve
u bëjnë
strehë,
Krahëdegësh

përqafuar
në heshtje,
Një urë
zemrat
sjell
pranë,
Aromë
barnjomë
deh
dy
trupa,…
Fëshfërima
gjethesh
shkrihen
ndër
puthje,
Dielli
deh
me rreze
pranvere;
Një
varkë
nis
udhëtimin
mbi valë,
për tutje…

7 Tingull puthje

Tingull,
depertuar qiellit,
oshëtin puthja,
Larg,
mijëra dritëyje,
më shpije…
Afrohet,
largohet,
aty,
mbetet përsëri…
Mbi buzët e mia,
Simfoni
ujëvare sjell,
derdhet si
rreze e gjatë
pafundësie,
Me aromë
gjethepranvere
më mbështjell,
Vesë
pikon
mbi çdo qelizë,
ngjyros sytë:
përçon
dritë universi …

8 Pentangram mbi natë pa yje

Natë pa yje,

Hëna fshehur tinëzisht,

dridhje e trembur, njerëz tremb;

Errësirë me pikëpyetje,

pikëçuditëset përkund

Në ç planet je ?!

Me ç frekuencë je lidhur?!

A ka shpirti ftohtë ?

Ke frikë kësaj nate të pustë?!

Dorëmpira fërkon dhimbje,

Truppërmbysurit shpirtin

lënë peng vetmisë,

E pakuptimtë kjo natë pa dritë,

Trullogaritsit lodhin ëndrrat,

Endërrthyesit lindin shpresa për ardhmëri,

Astmatikët numërojnë frymëmarrje,

Kardiakët matin pulse,

Internetasit vrasin orë,

Qarje fëmijësh shkundin natën,

Kukuvajkat përcjellin ekstrasistola,

hapin gropa të djegura Duhanpirësit,

Duar rrëshqitëse mbi lëkurëbardhë pëshpëritin eros;

Duardridhurit shtrëngojne barela,

Tingull puthje njomur buzësh të nxehta akullta,

Shi- errësirë tret trupa lodhjes,

Politikanet imazhojnë veten,

këmbadoras mbi kokë votash

Zotit i lutem, për pak bekim,

Kthetra gllabërojnë meridianë në Glob,

Sypërgjumërit

drejtojnë direkë anijesh,

valëdehur ëndrrave

përplasen me errësirrën.

Në një cep rruge

katër rrota shuajnë një zemër,

Në dritë neoni fustanbardha

pikon lot kristali, verë, vesë.

Tik-tak orë,

Pika shiu mbi asfalt ndezin buzëqeshje,

Kandilë të shuar vajtojnë,

Poetët lodrojnë mes yjesh feksur qiellit.

Optimistet dashurohen me meteorë,

Dy palë sy kërkojnë dritë,

duke çjerrë errësirrën e natës,

me refren jete në lindje.

Sonte u luajt doremifasolasido,

Natë e mbarsur rëndë,

abortoi dhimbshëm agimit.

Koha dëshmitare kthehu faqe të re,

në zbardhërim të brishtë.

9 S'vdes shpirti

Flatrim mes reve,

Kandil i shuar nga dy sy,

lotuar në errësirë,

kërkojnë dy buzë,

Drita vegimesh ndrin fytyra,

në erë puthja prek buzë në aromë,

Shpirti udhëtar i dashurisë

jeton parajsën në dy botë.

10 Arratisur

Aty mbeta gjithmonë,

Krahut të dashurisë përqafuar,

dehur aromës barënjomë,

Mahnitur shpirti duarve të tua,

stolisur kurorë lulesh në ballëmpirë puthjeve,

Sythe rënë flokëve djersirë,

Natyra dhe unë,

Ti dhe natyra, dashuruar në çdo grimcë ajri,

Nektarë lulesh pijmë në buzë,

aty mbetëm gjithmonë…

Arratisur bilbilimit të zogjve në flatrim…

11 Sa rron dashuria?!

Dashuria s njihka moshë…

Po vete dashuria moshë a ka?!

Jo rastësisht kalon nëpër rrugica gjatoshe…

Mund të ndodhë të shëtis,

nëpër kthesa në humbje,

ferrash mbuluar…

Eh, nëse ti, i dashur, nuk ecën në ritëm,

Udhës së gjelbëruar,

Humbëtirës do të zhytesh,

sa, as zërin tim,

s ke për ta dëgjuar,

andaj të lutem,

kthehu në një puthje të bekuar.

Dua të mat moshën e dashurisë së vërtetë.

12 Kur ngjiz jetë në sytë e tu

Sytë e tu përkëdhelin butësisht vështrime,

Bulëza të nxehta ngrohin trupa, lotin prek,

s njoh formula në dashuri !

Unë e preka, e jetova,

lumturoj shpirtin.

Pres të nesërmen

të mbulohem me puthje pa fund,

për Ty, dashuri e parë ,

jam e fundit për ty,

e tillë mbeta…

E di, kjo është e mundur.

S dua të humbas,

s do të shkoj larg,

duke lënë pas shpirtrat tharë,

nga etja për pak dashuri.

E ndjej prekjen tënde,

kam frikë mungesën tënde.

Ti jeton jetën time, unë prek çastin tënd,

ndërsa anija e jetës rrit shpejtësinë,

ndjej të të mbaj shtrënguar,

krahëhapur ditënetëve pa ndasi, pa ritual ndjenje.

Endrrat e mia janë prelud jete,

nëse do të më zgjojë nga kjo qetësi, do të hapja sytë të

të thosha:

"Më ler të fluturoj në Univers,

bashkë me ty të ngjiz jetë syve të tu!"

~~~
~~~

CURRICULUM VITAE

Emri: Mimoza

Atësia: Thoma

Mbiemri: Agalliu

E-mail: mimozaagalliu@yahoo.com

Kombësia: Shqiptare

Data dhe vendi i lindjes: 19.07.1962, Tiranë.

Statusi Civil: Martuar.

Arsimimi:

2009-2010 MASTER në Gjeografi Humane - Fakulteti Histori Filologji, UT: Menaxhim Mjedisi dhe Territori, në shkencat humane, Diplomë me Temë: "TË DREJTAT NDËRKOMBËTARE TË MINORITETEVE".

2009-2010 MASTER për Menaxhim Spitalor dhe Publik - Universiteti "KRISTAL" (notë mesatare 9,5); - Diplomë me Temë: "Kujdesi Infermieror dhe Edukimi Shëndetësor në parandalimin e sjelljeve të rrezikshme për shëndetin te fëmijët e shkollave.

1999-2005 UT - Fakulteti Histori - Filologji, Dega - Gjeografi Titulli: Mësuesi. "TË DREJTAT NDËRKOMBËTARE TË MINORITETEVE

2007- 2009 Fakulteti i Infermierisë - Universitetit "KRISTAL" (me notë mesatare 9,7);

1981-1983 Shkolla e Lartë për Nd/mjeke-Tiranë, (me notë mesatare 9,5);

1983- 1984 Kurs intensiv për gjuhën Angleze (Pasuniversitar).

1977-1981 Shkolla e Mesme e Përgjithshme "50 Vjetori i Pavarësisë" (me notë mesatare 9,4);

Njohuri për gjuhët e huaja:

1996 Anglisht (me dëshmi, notë maximale) nga Universiteti i Tiranës - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Kam njohuri, dhe për gjuhët: Italisht & Spanjisht.

Kualifikime profesionale:

Qershor 2008 - Trajnuese pranë ASHR "Trajtimi dhe Parandalimi i Dhunës me bazë Gjinore në Sistemin Shëndetësor" (United Nations Population Fund). Fondi i Kombeve të Bashkuara për popullsinë.

Tetor 2003 - Trajnuar në kuadër të projektit: "Gratë në Udhëheqje", realizuar nga UNDP.

(Rrjeti i Grave Milenium):

Prill 2002 Trajnuar në kuadrin e Projektit: "Gratë Mund t'ia Arrijnë". 2 "Gender Task Force " i Paktit të Stabilitetit (Rrjeti i Grave Milenium)

Mars - Prill - Universe Computer Center (UCE), për programet: Windows Profesional.

2002-2000 - Microsoft Word, Exel, Power Point ect.. me Çertifikatë,

2000-2002 - Provim për Doganiere pranë Drejtorisë së Doganave, fituese dhe vlerësuar me (70 pikë me gojë dhe shkrim) nën mbikqyrjen e OSCE-së organizuar nga Ministria e Financave (me dëshmi).

15 Mars 2006 - Anëtare Delegacionit Shqiptar "SPRING CONGRESS SESSION" për Qarqet Rajonale të Europës (Expert) Strasbourg,

29 Maj 2006 13 EME SESSION DU CONGRES (Expert) Strasbourg,

16 Tetor 2006 INSTITUTIONAL COMMITTEE-Salle 6, (English translator) Strasbourg,

Experiencë Profesionale:

2003 -2010 Pedagoge e jashtme në Fakultetin Publik të Infermierisë në Universitetin e Tiranës. Lënda: - Anglisht mjekësore,

2007-2013 Pedagoge e jashtme në Fakultetin e Infermierisë në Universitetin "KRISTAL" përkatësisht për lëndët:

- Infermieristike e pergjithshme - Teori infermierore,

- Tematike komunikimi - Infermierimi në Sëmundje të brëndshme,

Higjenë e aplikuar - Menaxhim Territori dhe në kushtet e shtëpisë,

Formim profesional - Infermierimi në Obsentrikë Gjinekologji - Infermierimi në pediatri.

2010- 2013 Pedagoge e jashtme në Universitetin "Mbretëresha Geraldinë"

Për lëndët: - Kujdes infermieror në Neurologji - Psikiatri - Geriartri - Shëndet Mjedisor,

2006 -2007 Mësuese e Gjeografisë dhe Historisë më kohë të pjesëshme pranë ISPU. "ALPHA" (Instituti i Studimeve Para Universitare),

2003-2006 Këshilltare, Njësia Bashkiake Nr.6, (zv.kryetare e grupit socialist),

2011-2015 Këshilltare, Njësia Bashkiake Nr.6, (zv.kryetare e grupit socialist),

1991- 2015 Inspektore shëndetësie në ASHR- (Autoriteti Shendetësor Rajonal),

1983- 1991 Nd/mjeke në Klinikën e Neurologjisë Spitali nr, 5

CV Politike

1992 Anëtare e Partisë Socialiste dhe FGSSH.

Në veprimtarinë time politike dalloj si më të rëndësishme arritjet si më poshtë vijon:

***-** Organizatore dhe themeluese e PS në Nj. nr. 6 në vitin 1992,*

Nga viti 1992 e deri më sot: Kryetare organizate në QV (qendra e votimit) 1858, 1858/1, 1958/2 në Tiranë.

Nga viti 1992 e deri në zgjedhjet e vitit 2013 (gjithmonë fituese në QV. 1958 me rezultat të lartë në rritje).

1992-2005 Komisionere në QV të Nj.Nr. 6 në Tiranë, për çdo zgjedhje.

1992-2000 Koordinatore dhe përkthyese e OSCE, ODHIR për Zgjedhjet në Nj.nr. 6, Tiranë.

1992 deri më sot: Pjesëmarrëse në të gjitha Kongreset e PS me të drejtë vote, dhe aktive në të gjitha aksionet politike të PS në Njësinë Bashkiake Nr. 6 dhe të Tiranës.

Nga viti 2000 deri në vitin 2005 Zv/kryetare e Komitetit Drejtues të PS-së në Njësinë Bashkiake Nr.6 në Tiranë.

Dy herë kandidate për Kryetare të Njësisë Bashkiake Nr.6, përkatësisht në zgjedhjet e 2007 dhe të vitit 2011.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009 kam qenë vëzhguese në KZAZ e Njësisë nr.6 në Tiranë.

Aktualisht Këshilltare në Nj. Nr.6 në dy mandate 2003-2005 dhe 2011-2015

Qershor 2015 - kandidate për këshilltare Bashkia Tiranë.

Shkrimtare:

Si shkrimtare kam një sërë botimesh si vijon:

- Vëllimi i parë poetik "ÇELNAJË" Prill 2013, vlerësuar me çmimin "POLEART" nga "PEGASI" Albania botuar dhe në: Gazetën e përjavshme elektronike "NEW LIFE" në NY USA; në:

http://www.scribd.com/doc/144314109/Newsletter-Volume-5-Issue-21 (29, 31, 32, vazhdon.).

- Vëllimi poetik "SHTATORJA E KURORES" Shtator 2013 në tre gjuhë.

Libri historiko-social "Mbrojtja Ndërkombëtare e Minoriteteve" Shtator 2013,

Kam në proces botimi Dy Vëllime poetike dhe një vëllim me Esse dhe Tregime;

Kam në proces përgatitjeje një Roman, një vëllim me tregime;

Autore e disa shkrimeve "Bukuria dhe Shëndeti në Fokus";

Autore sistematike në Suplementin "Pena Shqiptare", Poezi, Esse, Skica në gazetën "TELEGRAF";

Autore sistematike në Gazetën letrare "MUZGU";

Autore pjesëmarrëse në 12 Antologji të gazetës 'Muzgu' me shumëllojshmëri tematikash;

Autore sistematike në Gazetën letrare "DRITA";

Autore në Gazetën 'NACIONAL';

Autore në Revista dhe gazeta në Diasporë si; "Fjala e lirë", "Bashkimi Kombëtar", "Dituria", " Pashtriku.org", "Kosova Lindore", etj.

Botime në gazetën e përjavshme "Horoskopi" faqja letrare.

Pjesemarrëse në librin e ri të Prof.Murat Gecaj "Për ju krijuese";

Pjesemarrëse në librin e ri të Prof.Murat Gecaj "Me shpirt dashurie";

Recezente e vëllimit poetik "Magjia e Mjaltimit", maj 2013.

Pjesëmarrëse në veprimtari të ndryshme letrare dhe organizatore e disa veprimtarive letrare e shoqërore me Lidhjen, vlerësuar me çertifikata të ndryshme.

Nga viti 2010 e deri më sot jam Zv/kryeredaktore e Revistës dhe gazetës "PEGASI" Albania.

Pjesëmarrëse, si autore në Kolanën Antologjike (12 Vëllime) tek "Muzgu".

Pjesëmarrëse, në Antologjine Poetike 2013 "Korsi e hapur' (anglisht, italisht)

Pjesëmarrëse, në Antologjine Poetike 2014 'Korsi e hapur' (anglisht, italisht)

Për TRE librat e botuar intervistuar dhe vlerësuar nga Media e shkruar dhe vizive si: TV Klan, TV Planet, Radio Tirana, Gazeta 'Telegraf', Gazeta Letrare "Muzgu", "Drita", Horoskop" etj.

ÇMIM I PARË për Esse dhe Skica në Gazetën Telegraf në Suplementin 'Pena Shqiptare', në garën e Personazhit të Vitit 2014.

Anëtarësime:

Nga viti 2005 e në vazhdim: Anëtare e LNPSHA "PEGASI" ALBANIA,

Anëtare e AKADEMISË ALTERNATIVE PEGASIANE,

Sekretare për Marrëdhëniet, Shkëmbimin Universal të Vlerave në Letërsi dhe Art e LNPSHA "PEGASI".

Anëtare bordi, dhe bashkëpunëtore në gazetën 'Horoskop',

Anëtare e Shoqatës së Miqësisë Shqipëri - Izrael,

Anëtare e LANÇ-it.

Të dhëna mbi karakterin:

Kam aftësi komunikimi, përshtatem shpejt ndaj ambientit; preokupohem shumë pas punës dhe jam shumë rezultative; këmbëngulëse në arritjen e rezultateve, dhe në thellimin e studimeve të mia profesionale si dhe Kërkimeve Shkencore.

Kam njohuri të mira në disiplinat e Filozofisë, Shkencave Sociale, Letërsisë, Histori-Filologjisë.

Studimi dhe puna është moto ime në jetë!

~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~

© Pashtriku.org, Tetor'2015

~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~